



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP.Nr.0752/2024

Data e vendimit: 09.09.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore" me numër të prokurimit 616-24-4660-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës, U.d Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së z Agim Sheqiri me datën: 09.09.2024, mori këtë:

VENDIM

I. Hedhet si palejuar, ankesa e Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A me nr. të protokollit 2024/0752, e datës 22.08.2024, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: "Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore" me numër të prokurimit 616-24-4660-2-1-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e "Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore" me numër të prokurimit 616-24-4660-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 22.08.2024, ka pranuar ankesën e OE. "Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore" me numër të prokurimit 616-24-4660-2-1-1, i iniciuar nga Komuna e Prishtinës

Me 16.05.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ku afati i fundit për pjesëmarrje është me datën 24.06.2024.

AK me datën 13.08.2024 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës. AK me datën 19.08.2024 ka publikuar njoftimin për nënshkrimin e kontratës.

Operatori Ekonomik "Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A, me 22.08.2024, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 752/24 (Nr. protokollit) kundër vendimit të AK-së.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave* -

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore" me numër të prokurimit 616-24-4660-2-1-1, me datën 16.05.2024 është publikuar në sistemin e-prokurimi njoftimi për kontratë, me datën 13.08.2024 është publikuar njoftimin për dhënie të kontratës

Me datë 22.08.2024, OE Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokollit 752/2024.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, konstatohet se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar për faktin se sipas nenit 109 të LPP-së operatori ekonomik mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së vetëm nëse ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit dhe ka ofertuar me pretendimin për tu shpërblyer me kontratë ndërkaq sipas procesverbalit të hapjes së datës 24.06.2024 nuk figuron që OE Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A ka qenë palë pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në këtë fakt, OSHP e konsideron ankesë e OE si të palejuar konform nenit 4.1.26 të LPP-së ku sipas secilës dispozitë secili OE i cili ushtron ankesë në OSHP, duhet ta dëshmoj statusin e palës me interes për aktivitetin përkatës të prokurimit, sikurse është përkufizuar me nenin 4, paragrafi 1, nën- paragrafi 26, (shprehja “palë e interesuar”) lidhur me paragrafin 1, nën-paragrafi 5, të nenit 111, të LPP.

Nëse në përmbajtjen e ankesës (sikurse në rastin konkret) nuk dëshmohet se OE nga cilësia e tij/sajë si ankues, ka interes juridiko-material për aktivitetin përkatës të prokurimit për të cilin ushtrohet ankesa, OSHP ka të drejtë që ankesën ta hedhë si të palejuar, kurse shumta e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore konfiskohet dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sipas nenit 31, paragrafi 1, të Rregullores së punës të OSHP.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar sepse nuk ka respektuar dispozitat ligjore të shtjelluara si më lartë, andaj i lejon autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimore” me numër të prokurimit 616-24-4660-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimin të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padë mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

OSHP-së

1x1 AK – Komuna e Prishtinës

1x1 OE ankues

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri

UD. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

